



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

|                             |            |                      |                   |
|-----------------------------|------------|----------------------|-------------------|
| Prahuar - Primiteno Me Dina | 15-11-2024 |                      |                   |
| Nr. Logjistik<br>Org. Broj  | Numri Broj | Shtetje e<br>Endorzi | Vlera<br>Vrednost |
| 07                          | 060/01-    | 1296                 |                   |



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e XI të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **20.11.2024 (e Merkurë), në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

### R e n d d i t e

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënen në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën kadastrale në Vërban.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba me nr. 01-110/05-1151, e datë 30.09.2024.
- Informatë nga Drejtoria për Bujqësi për planin operativ për mbjelljet vjeshtore për vitin 2024-2025.

Viti, më 15.11.2024

Me respekt!  
Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### NGA MBLEDHJA E DHJETË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **23.10.2024 (e mërkurë)** në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri. znj.Majlinda Shabani, znj.Zyrafete Rama. Mungoi, z.Illir Zuka. Morën pjesë edhe drejtoret e drejtoreve. Pasi u konstatua se prezent janë 6 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkyetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së dhe ju tē pranishëm. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dhjetë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Para se me hi në rend të ditës, hapi diskutim jashtë rendit të ditës.

**z.Ramadan Deliu:** Përshëndetje për të gjithë! Nënkyetar, e kam pas ngritë çështjen e ujit këtu te Godent. Ke pas thanë që “Hidromorava” i ka nda paret që nje vit, ende nuk u rregullu aty, duhet me u lidhë tek shkolla e mesme andej nga ana e majt.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Nënkyetar, a ka naj informatë kur përfundon puna e sheshit se nuk po diet kur po përfundon ky projekt, dhe du me diskutu për mbledhjen e kalume të kuvendit komunal, për buxhetin, sepse ne këtu në KPF kur diskutum e ngritëm si shqetësim çështjen e vonesës së listës për investime kapitale, e besoj që keni me pas konë dhe hapësirë me shiku dhe me dhanë vërejtje deri në kuvend. Këtë e ki thanë nënkyetar e neve na ka ardhe lista vetëm në kuvend e atyre projekteve, e cila listë u shpërndaa e unë e kam një listë këtu që i gjanë mbi 26 projekte që edhe e shkelin ligjin. Për këtë po na duhet neve me e analizu edhe me i dhanë vërejtjet tona. Lista e investimeve kapitale na ka ardh aty për aty edhe vetëm u votu pa e analizu, edhe qeshtu po dështojmë në projekte, sepse ka projekte të vitit 2023, 2021 e që janë në parashikime në 2027, e për këtë po thamë që duhet me pas listën për investime kapitale me herët për me e analizu.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshëndetje! Edhe unë i kam dy çështje të para, është rregullimi i rrugës rreth lumit “Morava”, që është me kubza. Unë nuk e di a kanë përfundu të gjitha punimet aty edhe a ka mu bë diçka më qartë rrugë apo ka me mbetë qashtu, sepse janë tu pas shumë vështirësi dhe realisht ajo rrugë nuk është që ju ka lehtësu qytetarëve qarkullimin aty, përkundrazi ka pas shumë ankesa aty, edhe veturat janë tu prishë, përderisa po e kalojnë atë rrugë, kështu që a parashihet edhe diçka tjetër me punu aty apo ka përfundu puna, dhe përpos kësaj deshta me e ndërlidhë me listën e investimeve kapitale, sepse neve në KPF paraprakisht na ka ardh një listë tjetër mandje në kuvend ka ardhe një list tjetër aty per aty, mirëpo gjatë diskutimeve që i kemi pas me kryetarin e kemi pa që kryetari e ka pas edhe nje listë tjetër që ne realisht nuk e dimë se cilën listë të investimeve kapitale e kemi votuar atë ditë, edhe nëse nuk gaboj mundemi me pa në procesverbal, ku ti kryesus ki thanë që qajo listë e investimeve kapitale që votohet këtu dhe që e kemi na, qajo listë shkoj kështu që nuk e di a u përfshi diçka që ka dashtë më e përfshi kryetarin që na nuk e dimë apo ka qenë ajo listë që u votu aty per aty, që ka ardh me vonesë. Nëse mundemi me pas këtë informacion.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Qajo listë që votohet aty çka e kemi pas në KPF, e që janë shtuar edhe dy çështje, dy kode, qajo listë u shku, asnjë çështje jashtë kuvendit nuk guxon me u nënshkru, se është antiligjore.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Përshëndetje të nderur të pranishëm! Mbes me shqyrta shqetësimit e

Ramadanit. Sa i përket sheshit, më doket që është informata e prokurimeve, po e la ndoshta ai e dinë më saktë se kur do të përfundon ky projekt. Lista e projekteve që u tha se 26 projekte janë që e shkelin ligjin. Unë konsideroj që ndoshta ligjin nuk e shkelin, se qajo listë, qaj buxhet ka me ju nënshtru porocedurave në shikimin e ligjshmërisë, e nëse ata konstatojnë, ata e kthejnë që sa konform të ligjit. E kryetari e ka thanë atë ditë, përderisa një projekt nuk është pranu teknikish, nuk i janë dhanë paret, ai duhet me ekzistu si kod i atyre që ndoshta zgjatë me 4-5 vite. Patët pyetje edhe për rregullimin e kubzave, edhe këtë e la, përgjigjet Zyra e Prokurimit e kemi prezent. E lista e investimeve kapitale e pat të sakt kryesuesi që e tha, çdo sen që votohet në kuvend ajo është ligjore dhe obligative për implementim nga ana e komunës, pikërisht për këtë janë këshilltarët e kuvendit komunal që i ngrisin çështjet, që projektet të cilat i kemi votu, pse nuk janë qu, apo në rast se ka ndryshim, sërisht duhet me e bë përmes juve.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Miratimi i buxhetit ende nuk është zyrtar, duhet me shku ne Kuvend të Kosovës e me dal në gazetën zyrtare e tanë bëhet ligj.

**znj.Majlinda Shabani:** Qe nga mbledhja e KPF-së kemi pas paqartësi edhe në kuvend komunal kur e kemi bë diskutimin. Ky është problemi që neve si këshilltar nuk na vjen materiali me kohë që me pa na me e analizu e me ditë se çka po votojmë. Në listën e investimeve kapitale që e kemi pas nuk është që ka pas specifikim të projekteve, kështu që i bije që kanë qenë shtrimi me asfalt të përfshirë 12-13 lokalitete të njëjta, kështu që nuk ka pas diçka të specifikuar dhe kjo është ajo paqartësia që neve në fillim të seancës e kemi pas dhe në fund kur u votu.

**z. Jakup Demiri:** Nënkrytar, aspektin ligor na e dimë, ki projekte të planifikuar së pari sheshin e ki të pa planifikuar e ki shumë projekte tjera. Problemi është se qat listën është e obliguar me e pru një javë përpëra.

**z.Hasan Aliu, nënkrytar i komunës:** I ndajmë projektet nga grandi i përformances, e sheshi është projekt i grandit të përformances, është të cilat janë votu në kuvend, është obligativ dhe sun i ik kryetari asaj çështjes se bashku me Zyrën e Prokurimit të cilës i shtohet në janar, që me fillu tenderimin e projekteve. Pajtohem që këshilltari duhet me e pas listën e investimeve kapitale.

**z.Jakup Demiri:** Po mu nuk më ka ardh lista, është shkel ligji këtu, sheshi nuk ështe as i planifikuar as i projektuar. Në shesh sot hala bëhen ndryshime.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Fatlum, lista kapitale ka ardh ne KPF. Qat listë a jav ke dërgu?

**Fatlum Demiri:** Në KPF jeni marr vesh me u bë disa ndryshime. Pasi që janë bë ndryshimet at listë e kame dërgua në kuvend.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Këtë lisë që e ka dërfu Fatlumi, tanë edhe në kuvend kanë ardh edhe dy kode të tjera që janë ndryshu, janë bë plus.

**znj.Majlinda Shabani:** Mu me ka ardh nga Fatlumi fotografia që u kanë lista e investimeve kapitale në dokument, ajo su kanë e bashkangjitur kur u publiku dokumenti.

**znj. Melihate Ajeti, drejtoreshë e financave:** Përvendetje për të gjithë! Po kyqem, se e di që u ardh me vonesë këtu në KPF, po e kemi diskutu të gjithë që ka me u ndryshu, ama nuk ka qenë e vitit të kaluar, po për kuvend kan ndryshu vetëm dy kode.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit për diskutim! Materialin e keni marrë me kohë. A ka dikush me shtu përend të ditës.

**z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë:** Përvendetje të nderur të pranishëm! Me mirëkuptimin e juaj unë kisha dashtë të hin në pikë të rendit të ditës Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi. Kemi pas kërkesat nga fermerët, ku si drejtori komisioni ka dalë në teren, e ka bë raportin e ne duhet me e aprovu e me dërgu në Qeveri për kompenzim. Unë kërkoj me mirëkuptimin e juaj me shti në rend të ditës.

**z.Majlinda Shabani:** Neve si komuna na lejohet me bë këtë raport, ama po me doket që jemi në vonesë në këtë proces. Më kujtohet që kur kanë ardh ata që kanë qenë si lloj komisioni vlerësues e kemi diskutu që përfshirja e fermerëve ka qenë numër shumë i vogël, më doket 36 fermer, kështu që tash është shumë mirë që është bë ky raport tanë edhe që po dorëzohet në qeveri që me mujt me u bë ky lloj kompenzimi.

**z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë:** Unë vitin e kaluar nuk kam qenë këtu, po e kam përcjellë punën e kuvendit. Janë kanë mbledhja e mujtit tetor e ne veprojmë në bazë të kërkesav që i kemi nga fermerët.

**znj.Majlinda Shabani:** Ka shumë fermer që nuk janë të njoftuar, po ju ikin njoftimet e afatet për kërkesa e anës se komunës është bë. Ka këtë raport e me dorëzu në kuvend, po unë kur e kam ngritë këtë çështje në kuvend, përgjigja e juaj ka qenë që, këtë vit ministria nuk ka ba rikompenzimin. Tash nuk e di sakt, por e di që komuna është vonu në këtë aspekt dhe lajmi ka dal tek fermerët që, ministria këtë vit nuk ka me bë kompenzimin e dëmeve.

**z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë:** Unë nuk pajtohem me këtë që e thave vitin e kaluar, periudhën e prillit e kemi pas dy takime me ministrinë dhe kompaninë e sigurimeve dhe i kemi ftu fermerët. Ka qenë ftesa publike ti shfrytëzojnë ato mekanizma që janë të caktuar me ligj, është web të komunës, facbook dhe njoftim pran zyrës së drejtorisë. E tek shpia nuk i shkojmë kërkujt me i thanë hajde bënë kërkesë. Këtë vit i kemi pas 33 kërkesa për me dal me bë vlerësimin e dëmit, një na ka ardh në shtator dhe ne jemi i obliguar në shtator me dal, dhe për këtë arsyen nuk jemi vonu, jemi me kohë taman.

**znj.Majlinda Shabani:** Si Drejtori e Bujqësisë, a dilni në teren kohë pas kohe.

**z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë:** Po normal që dalim në teren.

**z.Jakup Demiri:** Kjo puna për kompnezin e damit për vjet, se në një periudhë nuk ke qenë drejtor këtu. Këtu kemi diskutu në KPF dhe e kemi shty edhe për 1 muaj a 2, për me i trajtu. Krejt këtu e kemi shty atë punën e listës, se ka pas pak fermer që kanë apliku në Komunën e Vitisë, e tash sa jemi vonu, se unë nuk jam marrë me këtë. Qëta po du me qitë në dritë që, na kemi vlerësu këtë në KPF. Se me lanë për ndonjë muaj tjeter, se ka pak që kan apliku.

**z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë:** E kam vetëm dhe një kërkesë, meqenëse Majlinda është atje në parlament, ndoshta kishte qenë mirë me bë përpjekje edhe avokim atje me i pagu atyne 33 a sa kanë qenë nuk e di. Me ja u pagu dëmet dhe këtyre. Kishte me qenë mirë dhe kishte me qenë suksesi më i madhë dhe tash sa aplikojnë, Drejtorisë së Bujqësisë dhe komision që ka formu me udhëzim administrativ zyra e kryetarit, që jemi të obligueshmë me dalë në teren, dhe binduni që janë dalë komisioni, i kemi shënimet, fotografitë, kanë punu jashtëzakonisht në mënyrë profesionale. Ju kisha lutë me shti si pikë të rendit të ditës nëse i kompenzojnë ju rritet nera, nëse nuk i kompenzojmë nuk kemi çka bajmë.

**znj.Majlinda Shabani:** Unë veç e kam një apel që, për herat e tjera Drejtoria për Bujqësi që është, njerëzit që punojnë aty, me dalë në teren kur të bëhet një fatkeqësi natyrore, nuk duhet me pritë me ardh fermeri me të tregu ty që ju ka dëmtu ajo tokë bujqësore që e ke pas, por duhet me qenë në gjendje gatishmërie qata njerëz që janë tu punu me dalë ndonjëhere prej zyrës me shku me i vizitu vendet.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Majlinda, në diskutim je tu e hupë pak kuptimin, se je tu e bë debatin si në kafe. Çka të kish me diskutu i merrë përgjegjet, kjo nuk është asgjë që mundemi me bë ne, dhe në vitin e kaluar nuk ka marrë asnjë dhe vitin e kemi dërgu në kuvend e kemi sjellë 21 fermer kanë qenë që kanë bë kërkesë dhe vjet kanë dëme jashtëzakonisht të mëdha. Kjo punë shkon me procedurë, me kërkesë. Kush ka bërë kërkesë e kemi vlerësu, mirëpo nuk janë kompenzu vjet askund në Kosovë. Ne si kuvend e kemi për detyrë me miratu këtë raport. Ky raport shkon në qeveri nëse i kompenzojnë krejt ia kompenzojnë edhe Vitisë. A jeni që kjo pikë të hynë në rend të ditës. Pra, me të gjitha votat pro hynë në rend të ditës. Tani prezanojmë rendin e ditës.

## R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-shtator 2024.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm publik.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Draft Kodit të etikës për zyrtarët e Komunës së Vitisë.**
- 5. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjatë vitit 2024.**
- 6. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për nëntëmujorin 2024.**
- 7. Informatë nga DKA-ja mbi fillimin e vitit të ri shkollor.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat vazhdojmë me këtë rend të ditë. E qes në votim miratimin e rendit të ditës. Nga të gjithë u miratu rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

## 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa

**z.Jakup Demiri:** Në përgjithësi për shkak të jo lektorimit të procesverbalit i humb kuptimi në shumë diskutime. Unë i kam Dhanë Fatlumit disa vërejtje. Kisha kërku edhe me ardhë edhe njëhere.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës: a jeni që të miratohet procesverbal me këto vrejtje? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstineni miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës:

## 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Shtator 2024

**znj.Milihate Ajeti, drejtoresha:** Buxheti i aprovuar për vitin 2024 është 17 milion e 543 mijë e 24 euro buxheti i aprovuar për këtë nëntëmujor janë shpenzuar 15 milion e 415 mijë e 406 euro apo 87.87%, ndërsa buxheti i alukuar është shpenzuar 96.26%. Kjo shkallë e ekzekutimit ka ardh, sepse në këtë 9-mujor janë bërë pagesat nga thesari i vendimeve gjyqësore dhe kontratave kolektive në vlerë prej 3 milion e 278 mijë e 667 euro, në paga dhe shtesa janë ekzekutuar 2 milion e 839 mijë e 927 euro, shërbime, mallra 94 mijë 115, subvencione 3212 dhe investime kapitale 341 mijë e 441 euro. Vendime gjyqësore në këtë 9-mujor janë ekzekutu 3 milion e 278 mijë e 667 euro, ndërsa për 9-mujorin e vitit 2023 ka qenë 355 mijë e 244 euro, që do të thotë që për 2 milion e 922 mijë e 423 euro është më i lartë në krahasim me vitin e kaluar. Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2024 janë 1 milion e 29 mijë e 502 euro, të hyrat vetanake të realizuara janë 816 mijë e 299 euro. Shkalla e realizmit bazuar në planifikimin vjetor është 79.29%, ndërsa bazuar në planifikimin e 9-mujorit shkalla e realizmit është 105.74%, investimet kapitale në këtë 9-mujor, vlera e pagesës është 2 milion e 807 mijë e 803 euro që me këtë vlerë nuk janë përfshirë pagesat e kontratave kolektive krahasuar me buxhetin e aprovuar për investimet e realizuara, shkalla e realizmit është 710.8 krahasur me buxhetin e alokuar 75.74, investimet e 9-mujorshit të vitit 2024 janë më të larta në krahasim me 9-mujorin e vitit 2023 për 1 milion e 33 mijë e 278 euro apo 58.22% . Buxheti i shpenzuar për mujorshin e vitit 2024 është 15 milion e 415 mijë e 406 euro, ndërsa në 9-mujorshin e vitit të kaluar ka qenë 11 milion e 16 mijë e 594, që do të thotë që në 9-mujorshin e vitit 2024 shpenzimet janë më të larta për 439 mijë e 318 euro apo 39.92%. Këtu janë përshfirë dhe pagesat e vendimeve gjyqësore, d.m.th për kontratat kolektive, ndërsa kodet ekonomike janë shpenzu paga shtesa 104%, mallra shërbime 90%, komunali 87%, subvencione 71% dhe kapitale 84.96%. Në pika të shkurtra i ceka. Për çdo pyetje shtesë, materialin e keni marrë me kohë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Te faqja e pare, te ekzekutimi i buxhetit, të gjitha njësitë buxhetore. Kjo është ajo pjesa kryesore që i lidhë krejt. Problemi që na u ka lidhë neve te çështja e pagave, po shihet që buxheti i pa shpenzum është vetem 350 mijë euro. Ne e dimë që pagat janë diku 800 mijë euro për 1 muaj po edhe për 3 muaj i kemi rrëth 2 milion e gjysmë, që na duhet pagat për 3 muaj. Këtu janë vetëm 350 mijë euro. Tash ne e dimë që kanë qenë problemet dhe munden me na u përsër. A është ndonjë ujdi, ndoshta na pritë gjendja e njëjtë dhe në sektor tjerë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Këtë vit i kam propozu kryetarit që teknikisht dhe profesionalisht me i përgatit caktimin e grupit në krye me drejtoreshën, Beratin dhe Islamin, që ju kemi drejtu me 2 shkresa. Ju kemi tregu gjithë sektorëve pagat, MEF-it, që gjendja financiare është kjo e jona, edhe pse ata e shohin çdo ditë. Kanë kërku këta dhe një takim që ende nuk i kanë ftu, që vërtet në kohë të informohemi lidhur me çështjet dhe hapat që duhet ti ndërmarrin. Unë konsideroj që forma konsideron zgjidhje të nivelit qendor jo vetëm për Viti. Është fjala për kontraten kolektive. Në momentin që bëhet zgjidhja e kontrates kolektive asnjë nuk kanë problem për shkak se buxheti është i parapamë dhe hecin çështjet si duhet. Pa u zgjidh problemi i kontrates kolektive nuk ka zgjidhje të problemit, dhe në vitin e kaluar na kanë rimbursu diku mbi 1 milion. Këtë vit ende

nuk është bërë ajo çështje. Kjo çështje nuk po më pelqen, se ne jemi tu i knaq avokatët dhe përmbaruesit. A do ta shtinë me ja njoft në aspekt professional, por pa i pagu përmbaruesit për avokat apo do ta nderpresim dhe ti thomë stop kësaj pune dhe t'i lirojmë komunat në funksionalitetin e tyre. Neve na vazhdojnë telashet. Kështu kanë pas një takim kryetarët e komunave me kryeministrin, i kanë shpreh shqetësimet, por ky problem është I nivelit qendoror.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Krejt buxheti i pashpenzum i të gjitha njësive janë 2 milion e 127 mijë, d.m.th të gjitha janë këto. Tash krejt këto mi qitë në paga prap sun bëjmë zgjidhje.

**z.Jakup Demiri:** Ky problemi i kontrates kolektive është problem në nivel qendoror, po në këtë telashe mbetet veç Vitia, dhe në fund u munut me kamuflu këtë punë në konferencë për shtyp që tjetër kush i mbajke takimet me sindikata, me drejtorë të shkollave i mbajke, dhe tjetër i bajke, dhe kjo është shumë e pandershme. Më së pari kontraten kolektive nuk e kemi nënshkru, se kemi bë ne hiç, ajo ka qenë kohë fushate për vota, e ka bë PDK-ja, ndërsa LDK-ja e ka votu në fund, dhe tash me qatë fajin e vetë qohet kryetari i komunës ja vonon 10 ditë rrogat arsimtarëve dhe mësuesve në Komunën e Vitisë. Para 1 viti i kanë tregu çka me ba, si me vepru, asnjë hapë nuk e ka marrë, dhe kjo puna me dezinformu dhe me shpifë prej kryetrit tone, është tepër e ultë. Kryetari i Komunës së Vitisë është i dënum për shpifje. Për këtë edhe më heret kam folë për shpifjet që I bajke, dhe në fund që edhe gjykata e denon për shpifje. Krejt komunat kishin vepru sipas qasaj marrëveshje, udhëzimeve, ky jo. Mandej jam taku me vetë ministrin, më tha që kam folë me kryetarin të hanën në mëngjes më nuk ka pas qasje. Nënkyetar, më së pari është dashtë me kërkupi falje, se më së pari ti në konferencë nuk është dashtë me dale, po ai me dale, se ai e ka bë krejt këtë telash. Dhe të gjithë e dimë që ai e udhëheq Komunën e Vitisë. Ne i kemi punët keq, sikur në listen e investimeve kapitale sikurse KAB-i që e vëtmja Komuna e Vitisë nuk ka dorëzu hiç.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari I komunës:** A dal në kofenrencë për shtyp apo jo, mua nuk më ka leju ligji me pas një këshilltar, me pasë ndonjë e kisha pyet dhe nuk kam gabu. Nuk është e vërtet se e ka thirrë ministry, e ka thirrë Xhevati, dhe i ka thanë veç 2 orë i ke afat dhe nuk ka dhanë sqarime cila është forma. Dhe ti për 2 orë nuk mundesh me bë. Po donë me fajsu një kryetar të komunës se çka ka zëvendësministri i bujqësisë me sjellë problem. Zëvendësministri duhet me shku me thanë se, tu kanë dëmtu fermerët. Nuk përzihet bujqësia me arsim. Në rast se ata kanë qenë parimor, nuk bisedohet pa e thirrë kryetarin e komunës dhe drejtoreshën e arsimit. Kështu zgjidhet problem. Ata kanë qenë të parët që e kanë nisë këtë çështje ende pa dalë pagat. Paradite kanë dalë me deklaratë që pagat nuk dalin.

**z.Ramadan Deliu:** Më së pari rrogat kur i ka qitë në krejt Kosovën i ka qitë jashtëligjshëm, se nuk ka pas drejtor.

**znj.Majlinda Shabani:** Unë i pata disa pyetje për nënkyetarin, sepse me datën 16 gusht 2023 i ka ardh shkresë prej ministrisë për me bë korigjimin. Këto shkresat të vazhdushme që kanë ardh, që i kam pas të fotografume dhe që i kemi pa. D.m.th me datën 16 gusht 2023, Ministria e Financave i ka dërgu shkresë komunës për me bë qet korigjim. Nuk u përgjigj komuna. Me 27 gusht ministria prap ka kërkupi nga kryetari i komunës me bë korigjimin.

**z.Jakup Demiri:** Tek investimet kapitale 84.96, a ki informatë ti përafersisht që me ditë se në 23 dhjetor sa përqind duhet mi bë pagesat. Tek kodi 11131, kontributi pensional i punëtorit dhe kontributi pensional i punëdhënësit. Shpenzimet e anëtarësimit 8500, kodi 13501. Këto mobilet, pajisjet tjera, furnizimet mjekësore 115 mijë. Po qeto pajisjet tjetra që nuk janë të specifikuar. Banë një listë që së paku në kuwend me naj dhanë në mëngjes. Mirëmbajtja e rrugëve lokale 258 mijë e 205 euro. Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve 24 mijë, mirëmbajtja rutinore. Çka është dallimi këtu me mirëmbajten e rrugëve. Hartimi i projekteve. A din cilat projekte i ka hartu, se janë 215 mijë euro edhe unë e kam këtu një informatë për kompaninë projektuese "Florent Emini" B.I. vitin e kaluar. A i ka marr përmes përmbaruesit 145 mijë euro apo i ka marr në mënyrë të rregullt dhe cilat projekte i ka hartu. Kemi edhe një kompani nga Lipjani që i ka marr 42 mijë euro, plus 8% kamatë për mos ekzekutimin me kohë. Edhe kjo është vitin e kaluar.

**znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë:** Unë kam pyet për këtë Florentin. Më kanë thanë që nuk ka marrë. Kështu që edhe një here pyes.

**z.Jakup Demiri:** A ka Komuna e Vitisë kontratë me një kompani sllovene në vlerë prej 3.1 milion. Kjo kontratë në vitin 2025 përfundon. Unë jam kanë në takim me ministrin, i cili me ka thanë që mu ka anku një kompani sllovene për mos kryerjen e Komunës së Vitisë për 1 milion euro. A jeni në njoħuri se nëse kjo 3.1 milion euro kjo na falimenton, unë po flas publikisht.

**znj.Miliha Ajeti, drejtoreshë:** Për këtë kompani ne i kemi vetëm edhe 60 mijë euro që kemi me ja pagu. Kemi bë një marrëveshje me të, kemi thanë që nëse na bëhet problem i pagave duhet me na pritë me bë me rata, dhe kanë qenë dakord, pagesat tjera jan bë krejt.

**znj.Majlinda Shabani:** Ka edhe diferenca në shuma kur jemi te kodet e njëjta buxhetore. Nëse i marrim të gjitha njësitë buxhetore dhe nëse hymë me i pa nëpër drejtori, p.sh.: ka diferençë. Tash nuk e di a ka qenë gabim teknik, kisha kérku sqarime për këto. Te kodi buxhetor 13430, shërbime të ndryshme shëndetësore kur e kqyrë të të gjitha shërbimet buxhetore dhe te Drejtoria për Shëndetësi i ke diku diferençë 600 mijë euro. Pse është kjo diferençë dhe çka është e përfshime. Këtu a janë të përfshime edhe pagat që i kemi. Te kodi 13440 shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Çfarë këshilla jepen dhe ku jepen. Pajisje tjera, kodi 13509. Blerja e librave dhe veprave artistike, kodi 13510, kisha dashtë me ditë se çfarë libra janë blerë dhe ku kanë shku ato libra. Kodi 13511 janë pajisje sportive. Çfarë pajisje dhe cilat shkolla janë furnizu? 14022, mirëmbajtja e ndërtesava administrative dhe afariste. Çfarë mirëmbajtje janë bërë këtu, sepse e kam parë edhe kur është bë krahasimi prej vitit paraprak ka rritje diku 104 mijë euro. Mirëmbajtja e rrugëve locale. Cilat rrugë lokale janë tu u mirëmbajtë? Këto, kompenzimi i përfaqësimit brenda vendit 14310. Çfarë përfaqësimi është? Dhe pajisjet tjera 13509.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Nëse ke ndonjë përgjigje direct, nëse jo atëhere mund të përgaditesh me përgjigje për kuvend. Nëse ka mudësi te kjo pjesa e pagave që janë marrë nga kontrata kolektive. Sa janë që kanë marrë paga mësimdhënësit? Sa janë kamatë? Sa janë përmbarues? Sa janë avokat? Vetëm për infomatë na intereson me ditë, sepse nëse janë 5 milion, atëhere 2.5 milion janë që i kanë marrë avokatët dhe përmbaruesit.

**z.Hasan Aliu, nënkyrytar i komunës:** Deri para kuvendorit të kalum që e patëm në shtator, ne kemi qenë me 5 milion e 590 mijë. Jemi dëmtu si komunë nga kontrata kolektive në këtë shumë. Unë ka me kérku. Nëse është mundësia me ditë sa na kanë marrë përmbaruesit dhe avokatët, sepse nuk e di a e kanë.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Faleminderit për debatin! A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm publik**

**znj.Majlinda Osterglava, drejtoreshë:** Pëershendetje për të gjithë! Kësaj here kemi kërkesë nga pronari i cili ka kérku këmbimin e pronës komunale me atë private. Vendi është te *Gorenja*, është vetëm këmbim që sa japid dhe marrim, jemi brenda ligjit. Këtë e shpallim vetem zonë me interes. Në seancën e ardhshme vijmë për kembim.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Faleminderit! Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Draft kodit të etikës për zyrtarët e Komunës së Vitisë**

**znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore:** Pëershendetje për të gjithë të pransihmit! Kodi i etikes për zyrtarë të Komunës së Vitisë është një dokument i rëndësishëm, që përcakton standarde e sjelljes dhe përgjegjësisë etike për ata që ushtronjë funksione publike në administratën komunale të Vitisë. Qëllimi i kodit është të promovoje transparencën dhe përgjegjshmërinë në administratën komunale, të forcoj besimin e qytetarëve në institucione komunale si dhe të rregulloj sjelljet etike të zyrtarëve komunal në përputhje me vlerat dhe parimet e shtetit ligjor. Nuk po zgjatem më teper, pasi materialin e keni marrë me kohë. Për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj. Mua më ka angazhu kryetari. Ky kod është modalitet i Ministrisë së

Administratës Publike që ka ardhë para 2 viteve si model. Të gjitha komunat e kanë të afirmum kodin e etikës, mirëpo tash pavarësisht që kemi qenë në konsultim me Zyrën e Personelit, hartimin e këtij kodi, se nuk na është dashtë shumë ndryshime me bë, Zyra e Personelit po e kundërshton tani kodin, thotë me terhek shkaku që plotësim ndryshimit të ligjeve, Ligji për Zyrtar Publik që e obligon qeverinë qendrore me bë një rregullore të etikes.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** A jemi në përputhje me udhëzimet administrative dhe ligjet aplikative të Republikës së Kosovës.

**znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore:** Te gjitha komunat e kanë të njëjtë.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** E qojmë për kuvend. Konsultonu ju mirë deri në kuvend, nëse nuk përputhet me ligjet e terhekim në kuvend, nëse është në bazë të ligjit vazhdojmë me procedurat.

**z.Arian Alidema, zyrtar i personalit:** Konsultimi që kemi pas me Ibadetin atje në sallë të kuvendit, ne kemi kundërshtu, personalisht, për arsy se Ligji për Zyrtarë Publik nuk e autorizon, nuk është kompetencë me bë një kodë. Ky draftë ka rrjedh nga viti 2020. Aktualisht çka kam mujtë me vertetu, vetëm Komuna e Gjilanit e ka miratu në vitin 2020, ndërsa në 23.11.2022 qeveria e ka nxjerrë një vendim, për shkak se në këtë periudhë kanë ekzistu disa udhëzime dhe rregullore që nuk kanë pas bazë ligjore të funksionimit. Njëra prej tyre është rregullorja 04/2015 për kodin e mirësjelljes në shërbimin civil. Si rezultat i kësaj rregullore ka rrjedhë ky modalitet prej një organizate në bashkëpunim me komuna, për me draftu këtë kodë të etikes. Ddhe kjo çështje ka mbet, nuk e ka miratu prej 2022 askush, për arsy se 2020 ka hy një ligj në fuqi 116. Vitin e kalum ka hy ligji në fuqi 197 për zyrtarë public. Ky ligj vetëm me një nen e përcakton, është shkelje e lehtë, shkelje e detyrave të punës. Njëra prej tyre është edhe shkelja e kodit të etikës. Këtë kod qeveria deri më tani nuk e ka nxjerrë. Në këtë kod janë të autorizum qeveria dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Tjetër, kush nuk nxjerrë. Disa i ka nxjerrë qeveria, por kodin e etikës nuk e ka nxjerrë ende qeveria. Nëse hymë në detaje me kqyrë, këtu ka zbratz ligjore. Unë po kërkoj vetëm me terhek, se njëhere e kemi terhek prapë, tani prapë mos të na përseritet.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Është diçka shumë konfuzionale kur thua ti e konsideron shkelje të lehtë shkeljen e kodit të etikes. Në rast se nuk ke ti kodë të etikës, çka je tu shkelë. Njëhere e miratojmë e qojmë në ministri për konfirmim të ligjshmërisë e ata e konstatojnë a banë apo nuk banë.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Une kisha thanë le ta qojmë në kuvend e le të konsultohen këta deri në mbajtjen e kuvendit. E nëse duhet me terjek e terjekin në Kuvend. A jeni që të shkon në kuvend kjo pike? Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të dites kemi:

## 5. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjatë vitit 2024

**z.Valmir Sahiti, drejtor:** Përhendetje të nderuar të pranishëm! Më lejoni që para juve ta prezentoj informatën mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjatë vitit 2024, Komuna e Vitisë, respektivisht DKRS-ja ka hapur thirrjen publike për OJQ-të në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Konformë Rregullores 04/2017 kemi përzgjedh komisionin vlerësues në përbërje të cilave kanë marrë pjesë. Materialin e keni marrë me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Komisioni në çfarë përbërje ka qenë? A ka nga kuvendi pjesë të komisionit?

**z.Valmirt Sahiti drejtor:** Jo nga kuvendi nuk kemi asnë anëtarë, sepse rregullorja 04/2017 e përcakton përbërjen e komisionit. Një anëtar nga Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, një anëtar nga Zyra e Financave, një zyrtar ligjor, një anëtar nga shoqëria civile dhe një anëtar nga OJQ-të.

**z.Jakup Demiri:** Emrat e anëtarëve: a mund ta dimë kush kanë qenë.

**z.Valmirt Sahiti, drejtor:** Kryetare e komisionit ka qenë Sadie Dauti, Avdirrahman Haliti anëtar, Besa Mustafa anëtar, Ismet Sejdiu anëtar, Femih Rexhepi anëtar dhe Sadije Lutfiu anëtare rezervë.

**z.Jakup Demiri:** Mendoj që mirë kishte me qenë një anëtarë në këto komisione nga opozita.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Pasi që nuk ka për diskutim, a jeni që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shkon për në kuvend. Nga të gjithë të pranishmit u votua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjatë të rendit të ditës kemi:

## **6. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për nëntëmujorin 2024**

**z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit:** Përshendetje për të gjithë! Informatën e kam përgaditë me kohë. Materialin e keni marrë me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispoziconin e juaj.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Fadile, para se ma ja kalu fjalën të tjerëve. Kam një pyetje tek kontratat, se ne po dëgjojmë se një pjesë e projekteve vetëm nuk kanë pranu pranim teknik. Projektet e mëhershme a shkojnë përmes zyrës suaj, a mungjë na naj here me pas naj informatë? Cilat projekte kanë pranim teknik e cilat nuk kanë pranim teknik. Me e bë një informatë.

**z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit:** Për cilën periudhë kohore e kérkon këtë informatë, që të muj me e përgatit?

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Po mundet mu ditë për projektet e dy- tri vitet e fundit të cilët nuk kanë pranim teknik, të cilëve ju ka kaluar koha, edhe pse po ndodhin këto.

**z.Jakup Demiri:** Projektet pa pranim teknik deri sa perqin po e marrin vlerën e kontratës? P.sh.: kanalizimi i Smirës: edhe sa ka kushtu krej komplet?

**z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit:** Varet prej rasti në rast. Nuk ka pranim teknik, nuk realizohet pagesa. Tek kanalizimi i Smirës i ka 40 e diçka mijë euro, ndërsa ka kushtu 480 mijë euro.

**z.Jakup Demiri:** D.m.th 90% ju ka pagu, edhe pse nuk ka pranim teknik. E norma që ma nuk vjen ai, sepse e ka marr pagesën.

**z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit:** Ka pas vërejtje edhe prej menaxherit të kontratës. Krejt informatat i kemi në raport.

**z.Jakup Demiri:** Nuk po e kupoj këtë, një aktivitet me procedurë, me vlerë minimale prej 1000 euro. Kjo e dyta, aktivitete me një procedurë dhe punë shtesë 10%, nuk po e kupoj.

**z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit:** Aktivitet me mini procedurë është procedurat ku OQP-ja e bënë përzgjedhjen prej 3 deri sa do e në këtë rast është kjo për kompjutera, edhe e ka kualifikim me do, këtë 16 e miniprocedurë quhet kur tash na himë në kontratë të OQP-së.

**z.Jakup Demiri:** Tri aktivitete me procedurë të negociuar, se kryetari në takim kur ishim tek Jeta Xharra tha se, unë nuk e kam asnje procedurë të negociuar. Po tash po na dalin shtesë.

**z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit:** Këto janë punë shtesë, ndoshta kur ka thanë kryetari edhe nuk i ka pas, është kjo puna e hartave zonale. Ligji e kérkon kështu, i ka dy fazë, e fazë e dytë shkon e negociuar. E kemi edhe një tjetër punë shtesë ku kemi me 10% tek aneksi i shkollës "Ahmet Hajdari". Edhe tjetra është më doket 2000 euro.

**z.Jakup Demiri:** Deri kur e ka dinamikën e punimeve sheshi, kur e ka me përfundu.

**z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit:** Kontrata është dyvjeçare. Tash dinamikën edhe planin e ka menajeri. Unë nuk kam drejt me ja kérku, po me ja lyp naj bjen. Po e di që projektet e grandit të përformances janë 24 muaj.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** A ka tjera pyetje për këtë pikë të rendit të ditës? Pasi që nuk ka, kjo pikë nuk shkon në kuvend.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

## **7. Informatë nga DKA-ja, mbi fillimin e viti të ri shkollor**

**znj.Arta Ajeti, drejtoreshë:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! Materialin për informatën për fillimin e viti të ri shkollor 2024 - 2025 e keni marr me kohë. Nuk po ju marrë kohë me lexu, nëse keni pyetje, jam në dispozicionin e juaj.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Drejtoreshë, në shkollat e komunës sonë është problem uji i pijshëm, e se paku është mirë me e qit një njoftim që mos mu pi uji në shkollë.

**znj.Arta Ajeti, drejtoreshë:** Aty ku kemi kyoje me ujësjellës në të gjitha shkollat, kuptohet kur të ka reshje atmosferike, kur të nalet uji, e në shkollat tjera kemi puse. E sa është i pijshëm ujësjellësi, e nëse eshte i pijshëm tek ne është edhe në shkolla.

**z.Jakup Demiri:** Tek tualetet çfarë papastertije është. Është mirë me diskutu edhe me punëtorët teknik, me e mbajt pastertin aty.

**z.nj.Arta Ajeti, drejtoreshë:** Do të interesohem për këtë.

**z.Bekim Azizi kryesues:** Sa nxanësa janë me aftësi të kufizuar. Nëse nuk e ki informatën, tani naj sjellë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim: a jeni që kjo pikë të shkon në kuvend? Nga të gjithë u miratu.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

#### **8. Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi**

Drejtori e bëri elaborimin në fillim. A jeni që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shkon për në kuvend? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Me kaq e myllim këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

---

**Procesmbajtësi:**

**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**

**Bekim Azizi**

---



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrta e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrta e Republikës së Kosovës Nr. 2, e datës 15 Shkurt 2018), nenin 50, shkronja i të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kryetari i komunës së Vitisë më datë 11.11.2024 i propozon për miratim Kuvendit të Komunës së Vitisë këtë:

| Praniar / Primiplot Me Dated |            |          |          |
|------------------------------|------------|----------|----------|
| Nr. Logjistik                | Nr. e Proç | Ufrore   | Vlera    |
| Ora/Min                      |            | Të Paktë | Vrednost |
| 02-                          | 035/02-    | 1277     |          |

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

## PROPOZIOM V E N D I M

### për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025

#### Neni 1

##### Norma Tatimore

Me këtë propozim vendim Kryetari i komunes së Vitisë i propozon Kuvendit të komunës së Vitisë që të miraton vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2025 për të gjitha kategoritë e pronave në tërë Komunën e Vitisë, me përjashtim të kategorisë pronë publike dhe përjashtimeve tjera sipas legjislativit përkatës, më sa vijon:

Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri në 1.9 dhe Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, pika 1 si dhe pikat 1.1 për njësitë bujqësore të parcelave, 1.2 për njësitë bujqësore të objekteve, 1.3 për njësitë pyjore të parcelave, 1.4 për njësitë rezidenciale të parcelave, 1.5 për njësitë rezidenciale të objekteve, 1.8 për njësitë industriale të parcelave dhe 1.9 për njësitë industriale të objekteve, Kuvendi i Komunës së Vitisë cakton normat tatimore për vitin 2025 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronave publike, me sa vijon:

- |   |       |
|---|-------|
| 1.1 Për njëstë bujqësore të parcelave-----    | 0.15% |
| 1.2 Për njëstë bujqësore të objekteve-----    | 0.15% |
| 1.3 Për njëstë e pyjore të parcelave-----     | 0.15% |
| 1.4 Për njëstë rezidenciale të parcelave----- | 0.15% |
| 1.5 Për njëstë rezidenciale të objekteve----- | 0.15% |
| 1.6 Për njëstë komerciale të parcelave-----   | 0.17% |
| 1.7 Për njëstë komerciale të objekteve-----   | 0.17% |
| 1.8 Për njëstë industriale të parcelave-----  | 0.15% |
| 1.9 Për njëstë industriale të objekteve-----  | 0.15% |

#### Neni 2

##### Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Sektori i Tatimit në Pronë.

#### Neni 3

##### Hyrja në fuqi

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Primirat - Prindjenje Me Datan |             |                    |                   |
|--------------------------------|-------------|--------------------|-------------------|
| Nr. I. Organi<br>Ora Bro       | Nume i Broj | Shtetiqe<br>Përfaq | Vlera<br>Vrednost |
| 02                             | 033 62      | 1285               |                   |

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjn lokale nr. 03/L-40, të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershori 2008) dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5 paragrafi 1 pika 1.3 neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 13.11.2024, bën këtë :

### PROPOZIM VENDIM

#### Paraprak për dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraprak, propozohet të **jejet pëlqimi** për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshëme të Komunës së Vitisë , në shfrytëzim afatgjatë pësonave fizik dhe juridik deri në 20 vite , për ushtrimin e veprimitarës biznesore , respektivisht vodosjen e panelevë solare përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2.

Prona e palujtëshme për dhënjen në shfrytëzim , sipas nenit 1 të këtij propozim –vendimi janë:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zhabelj , me kulturë Kullosë e klasit të 6 , me sipërfaqe prej 96342 m<sup>2</sup>, e evidentuar sipas çertifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zabel , me kulturë Kullosë e klasit të 6 , me sipërfaqe prej 130577 m<sup>2</sup>, e evidentuar sipas çertifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Çmimi fillestari i pronave të palujtshëme komunale të cekura në nenin 2 , pika 1 dhe 2 të këtij propozim-vendimi do ta përcaktoj komisioni vlerësuar i ofertave për dhënjen e pronës së palujtshëme të Komunës në shfrytëzim afati gjatë.

Neni 4.

Qellimi i dhenjës në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale .

Neni 5.

Procedurat për dhënjen e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatgjat realizohet përmes shprehjes së inerit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Kembim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës.

Neni 7.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës , Zyra Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 8.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës  
Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN**

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Devajë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type            | Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup> |
|----------------------|----------------------------|--|
| P-70101018-00197-0   | Parcelë / Parcela / Parcel | 96342                                  |
| P-70101018-00200-0   | Parcelë / Parcela / Parcel | 130577                                 |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:7535



Punoi/Obradio/Created: Kushtrim Imeri

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Data/ Data/Date: 13.11.2024

Koha/ Vreme/ Time: 10:24:09



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živote Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Vitisë

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACIO OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesi)<br>Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa)<br>Last Name / Business Name | Emri<br>Ime<br>First Name | Emri babait<br>Ime oca<br>Father's Name | Gjinia<br>Pol<br>Gender | Nr. personali/biznesit<br>Lidni broj/broj<br>postolovanja<br>ID. No. | Shteti i shtetësë apo<br>regjistrimit Država<br>dizavljana ili ukuinjësja<br>Country of citizenship | Ditëlindja/Data e<br>themelimit<br>Rodendan/Dan<br>osnivanja<br>Date of<br>Birth/Establishmen | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|--|---------------------------|---|-------------------------|--|---|---|---|----------------------------------|
| Komuna e Vitisë  | /                         | /                                       | /                       | 600424486  | KOSOVA /<br>KOSOVA /<br>KOSOVO  | t   | 29.12.2020  |                                  |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësi e adresës<br>Pojednosti adrese<br>Address Details | Adresa tjeter<br>Druga adresa<br>Other address | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|--|---|---|--|----------------------------------|
| /                                      | /   | 28 NËNTORI  | KAKO<br>NA VITCA<br>DHE GEOFONI<br>GEOGRAPHICA |                                  |

**B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT**



| Kadstralna jedinica /<br>Geografska jedinica<br>Sektor / Municipality |  | Katastarska<br>zona /<br>Cadastral zone | Zona<br>katastarske<br>zone /<br>Cadastral<br>zone | Uloji i pronis<br>Vrsta imovine<br>Property kind | Tipi pravica<br>Tip imovine<br>Property Type                         | Kati/<br>Katet<br>Br.Sprat<br>al  | Vendi i kuqitur<br>Zvano mesto<br>Place name | Superficija<br>Povrsina<br>Area   | Shfrytëzimi<br>aktuall/Kultura-<br>upotreba/<br>Kultura-klassa<br>Actual<br>use/Culture-class | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota                              | Lloji i së drejtës<br>Vrsta prava<br>Type of the right | Azhuruar<br>Azurrano<br>Updated |
|---|--|---|--|--|--|-----------------------------------|--|---|---|---|--|---------------------------------|
| P-70101018-00200-0  |  | VITINA /<br>VITI                        | Devajë /<br>Devajë                                 | PARCELA /<br>parcel                              | Phone shqiptore<br>Drushtvena<br>Inovrina<br>Socially owned<br>Land  | ZHABELJ /<br>ZHABELJ /<br>ZHABELJ | 96342  | Bujqësore -<br>Kullosat - Kullosë<br>E Klasse 6 / /<br>Poljoprivredno -<br>Pasnjaci - Pasnjak<br>6 Klase / /<br>Agriculture -<br>pasture - 6th Class<br>Pasture / / | 1 / 1   | Posedim<br>individual<br>/ Individualna<br>Dražvina<br>/ Single possessor | Lloji i së drejtës<br>Vrsta prava<br>Type of the right | Azhuruar<br>Azurrano<br>Updated |
| P-70101018-00200-0  |  | VITINA /<br>VITI                        | Devajë /<br>Devajë                                 | PARCELE /<br>parcel                              | Prone shqipërore<br>Drushtvena<br>Inovrina<br>Socially owned<br>Land | ZABEL /<br>ZABEL /<br>ZABEL       | 130577                                       | Bujqësore -<br>Kullosat - Kullosë<br>E Klasse 6 / /<br>Poljoprivredno -<br>Pasnjaci - Pasnjak<br>6 Klase / /<br>Agriculture -<br>pasture - 6th Class<br>Pasture / / | 1 / 1   | Posedim<br>individual<br>/ Individualna<br>Dražvina<br>/ Single possessor | Lloji i së drejtës<br>Vrsta prava<br>Type of the right | Azhuruar<br>Azurrano<br>Updated |



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITINA - OPŠTINA VITINA

| Pranuar / Praniljeno Me Data: |             | B-11-2024          |                    |
|-------------------------------|-------------|--------------------|--------------------|
| Nr. Logjistik<br>Qyt. Pre     | Numeri Broj | Shtopje<br>Pozitiv | Vlera<br>Vlerësimi |
| 02                            | 035102      | 1284               |                    |



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëeverisjn lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008, nenit 17 pika 2 lidhur me piken 6 të Ligjit për dhënjen e pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim nr.06/L-092, neni 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbim e pronës së palujtshme të komunës dhe neni 10 paragrafi 2 pika i lidhur me nenin 50 pika 1, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 13.11.2024 bënë këtë :

### PROPOZIM VENDIM

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës

#### Neni 1.

Me këtë propozim – vendim , propozohet të formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrit të hapur për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afat gjatë deri 20 vite ( njëzet vite) për njësia kadastrale me nr. P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, me sipërsfaqe prej 96342 m<sup>2</sup>, e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë dhe njësia kadastrale me nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, me sipërsfaqe prej 130577 m<sup>2</sup>, e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Propozohet që komisioni sipas pikës 1 të këtij propozim- vendimi përbetet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

- Shefki Aliu- anëtar i komisionit-Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës.
- Mustafë Islami - anëtar i komisionit – Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës
- .....- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
- .....- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
- .....- Përfaqësues i Sektorit jo qeveritar.

#### Neni 2.

Me këtë propozim- vendim , detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.10, të datës 03.04.2019).

Komisioni vlerësus udhëheq me procedurat mbi dhënjen e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim si : shpallja e njoftimit publik për shprehjen e ineteresit , përcakton çmimin fillesttar , vlerëson ofertat dhe ja propozon kuvendit ofertën ma të favorshme, si dhe informacione shtesë.

#### Neni 3

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarve të komisionit kur do herë që kërkohet.

#### Neni 4

Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjes në shfrytëzim afatgjat të pronës së palujtshme të komunës ti zhvilloj proceurat e konkurrit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesesen anëtaret e komisionit dhe Zyra e Prokurimit në komunën e Vitisë.

#### Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI



Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale me nr. 03/L-40 dhe nen 24 të Ligjit Nr..06/L-092 për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale, neni 29 paragrafi 5 i Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës dhe nenit 50 pika l, e Statutit të komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kryetari i Komunës së Vitisë përmes Drejtorisë për Kadaster Pronë dhe Gjeodezi i Komunën e Vitisë, me datën 14.11.2024, propozon këtë :

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **REPUBLIKA KOSOVA**  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

| Pranuar / Prurja me Data  |                 | 15-11-2024             |                   |
|---------------------------|-----------------|------------------------|-------------------|
| Nr. Faksimil<br>Org. Biro | Drejtues/Objekt | Ndërprerje<br>Përkatje | Vlera<br>Vrednost |
| 02                        | 035/02          | 1292                   |                   |

**PROPOZIM – VENDIM**  
PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHME PUBLIK

## I.

Me këtë propozim vendim , propozohet të bëhet shpallja zonë me interes të përgjithshëm publik për palujtshmerinë, pronën private që evidentohen në emër të Sali (Bajram) Musliu për pjesën e parcelës kadastrale në sipërfaqe prej 52m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 297m<sup>2</sup> në ngastrën kadastrale me nr.3108. në vendin e quajtar “ Fshat Oborr ” në zonën kadastrale në Viti, për arrijen e qellimit të ligjshëme publik për nevojat e banorëve të qytetit të Vitisë.

## II.

Pas marrjes së këtij Propozim-Vendimit për shpalljen e pronës private si Interes i Ligjshëm Publik, Kryetari i Komunës do të inicojë procedurat e metutjeshme për kembimin e pronës private me atë publike për arrijen e qellimit të lartëzuar duke zbatuar Ligjit për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale dhe Rregulloren për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës.

## III.

Për zbatimin e këtij propozim - vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës , Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtjen të Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi.

## IV.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:

Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI



Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale me nr. 03/L-40 dhe nenit 50 pika l, e Statutit të komunës së Vitisë, Kryetari i Komunës së Vitisë, neni 4 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit për Shpronsimin e Pronës së palujtshme (Ligi nr.03/L-139) Ligji Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme, Kryetari i Komunës së Vitisë përmes Drejtorisë për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi në komunën e Vitisë me daten 14.11.2024 propozon këtë :

REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primi i Me Dana 10 - 11 - 2024 |            |                      |                   |
|--|------------|----------------------|-------------------|
| Nr. Llojtarit<br>Gra Breg                | Numer Breg | Zbatimi i<br>Pranuar | Vlera<br>Vrednost |
| 02-                                      | 035/02-    | 1297                 |                   |

**PROPOZIM – VENDIM****PËR SHPALLJEN INTERES TE PERGJITHSHEM NGASTRËN KADASTRALE NË ZONËN KADASTRALE NË VËRBAN**

## I.

Me këtë propozim vendim, propozohet të behet shpallja zonë me interes të përgjithshëm ngastra kadastrale me :

Pjesa e ngastres kadastrale me sipërfaqe prej 12000m<sup>2</sup> në numër të ngastrës P-70101008-00491-0, me sipërfaqe prej 26275m<sup>2</sup> në vendin e quajtur " Jarinski Breg Beli Dub" në zonën kadastrale në Vërban, në pronësi të D.S.S O. VITINA POLJOPRIVREDNO DO.BELI D.

## II.

Ngastra kadastrale e shpallur zonë me ineteres të pergjithshem si në pikën 1 të këtij propozim – vendimi në zonën kadastrale në Vërban bazohet në kërkesen e Kryetarit të Këshillit fshatit Vërban me nr.01-320/04-34889 e datës 19.09.2024 që do të shfrytëzohen për varrezat e lagjës së Sokolëve me qellim të interesit përgjithshëm publik. për interes të qytetarëve të komunës së Vitisë.

## III.

Për zbatimin e këtij propozim - vendimi do të kujdeset zyra e Kryetari të Komunës së Vitisë, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Financa e Komunën së Vitisë.

## IV.

Ky Propozim-Vendim hyjnë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:  
Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti

|                            |                   |
|----------------------------|-------------------|
| Praunar - Pranjeno Me Data | 12-11-2024        |
| Nr. Logjimit<br>Org. Broj  | 021 035/02 - 1829 |
| Numri Regj.                |                   |
| Shtetec<br>Princip         |                   |

Duke u mbështetur në nenin 58, pika h të Ligjit mbi qeverisjen Lokale Nr.03/L-040; nenit 50, pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë, nr.01-013/491, datë 21.04.2011; të nenit 14 paragrafi 1 dhe paragrafi 8.1 të Rregullores (qrk) nr.19/2024 për procedurat e përgjedhjes dhe emërimit të drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, si dhe duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë që ka, Kryetari i komunës së Vitisë më datë 11.11.2024 i propozon për miratim Kuvendit të Komunës së Vitisë këtë:

### PROPOZIM VENDIM

për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë

- I. Përmes këtij propozim vendimi kërkohet nga Kuvendi Komunal i Vitisë të miratohen dy anëtarët e propozuar për komisionin për vlerësimin dhe përgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë.
- II. Anëtarët e komisionit të propozuar nga DKA për miratim nga Kuvendi Komunal ka këtë përbërje:
  1. Zijadin Ahmeti, kryetar i komisionit, zyrtar i DKA-së
  2. Vjollca Zejnullahu, Drejtore e sh.f.m.u. "Skender Emërrlahu", Ramjan
- III. Përmes këtij propozimi vendim konfirmojmë se personat (nr. rendor 1 dhe 2) e shënuar më lartë përmbushim kriteret të jenë anëtarë të Komisionit, sipas Rregullores 19/2024 për procedurat e përgjedhjes dhe emërimit të drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.
- IV. Periudha kohore e mandatit të anëtarëve të lartëcekur do të jetë një vjeçare, nga momenti i miratimi të këtij propozim vendimi.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti.

Propozim Vendimi u dorëzohet:

- Kuvendit të Komunës së Vitisë
- Zyrës së Kryetarit
- DKA-së, Arkivit,

V.V

Kryetari i Komunës

Sokol HALEFI



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 9 dhe 13 të ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, kërkesën me Nr. 3826/2 e datës 08.11.2024 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM RREGULLORE  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES  
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA, ME NR. 01-110/05-1151, E DATËS 30.09.2024**

**Neni 1**

Me këtë propozim rregullore kemi për qellim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-1151, e datës 30.09.2024.

**Neni 2**

Te rregulloja baze neni 11 pika 11.3 shtohet edhe një nën paragraf 11.4 si ne vijim:

- a) Dru zjarri për  $m^3$ .....1,50€
- b) Dru zjarri mbi  $7m^3$ .....2,00€
- c) Dru teknik  $m^3$ .....3.00€

**Neni 3**

Te rregullorja bazë, neni 24 ndryshohet dhe i njëjti riformulohet për arsyje të ndryshimit të bazës ligjore si në vijim:

Neni 24, të hyrat nga bashke pagesat për shërbime shëndetësore janë të hyra të cilat realizohen në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr 03/2024, bashkë pagesat për shërbimet shëndetësore, sipas shtojcës 1 dhe shtojcës 2.

**Neni 4**

Te rregullorja baze neni 28 pika 28.2 ndryshohet dhe plotësohet si: Tarifa e takses administrative për leje ndërtimore, kategoria I-rë një euro e pesëdhjetë cent (1,50 euro) për metër katror.

Ndryshohet dhe duhet të jetë:

Tarifa e takses administrative për leje ndërtimore, kategoria I-rë duhet të jetë dy euro (2,00 euro) për metër katror.

**Neni 5**

Pjesët tjera të rregullores bazë mbesin të pandryshuara.

**Neni 6**

Kjo propozim rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Vitisë dhe certifikimi ligjor nga MAPL dhe MEF.

Propozues: Kryetari i Komunës së Vitisë  
Sokol Haliqi





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Republika e Kosovës

Drejtoria për Bujqësi Pyltari dhe Zhvillim Rural  
Nr. 10  
Datë: 12.11.2024  
VITI

Komuna e Vitisë

|                                       |                    |           |
|---------------------------------------|--------------------|-----------|
| Pranuar i fundit më: Dita: 12-11-2024 | Sip. e planifikuar | Vlera     |
| Nr. 10                                | Org. Bro.          | Vredhrost |

Informatë për mbjelljet vjeshtore

PLANI

Operativ për mbjelljet vjeshtore për vitin 2024 – 2025

Ky vit ka qenë veçanërisht i favorshëm për mbjelljet vjeshtore, falë kushteve të mira atmosferike që kanë lehtësuar procesin e mbjelljes dhe rritjen e sipërfaqeve të kultivuara. Subvencionet e ofruara kanë shërbyer si një motiv i rëndësishëm për bujqit, duke nxitur një interes më të madh në kultivim, edhe pse kjo kulturë mbillet kryesisht për shkak të traditës së rrënjosur në zonë.

| Nr. | SEKTORI     | KULTURA        | Sip. e planif. për ha | Rendime nti i planifik. për ha | Sasia e farës për ha | Sasia e pleshut për ha | Gjithësej sasia e farës në ton | Sasia e NPK dhe NAG 50%-50% | Lëndë djegëse për ha | Gjithësej Lëndë djegëse në L. |
|-----|-------------|----------------|-----------------------|--------------------------------|----------------------|------------------------|--------------------------------|-----------------------------|----------------------|-------------------------------|
| 1   | INDIVIDUA L | GRURË          | 3524.82               | 5000 kg                        | 300 kg               | 350 kg                 | 1057.446/ ton                  | 1233.637/ ton               | 40 L                 | 140,992.8 L                   |
| 2   | INDIVIDUA L | ELBE BIRRE     | 3.94                  | 3000 kg                        | 200 kg               | 300 kg                 | 788/kg                         | 1.182/kg                    | 40 L                 | 157.6 L                       |
| 3   | INDIVIDUA L | THEKËR         | 3.52                  | 2500 kg                        | 250 kg               | 300 kg                 | 880 /kg                        | 1056/kg                     | 40 L                 | 140.8 L                       |
| 4   | INDIVIDUA L | BIMË FORAXHERE | 28                    | 4000kg                         | 50 kg                | 300 kg                 | 1400/kg                        | 8400/kg                     | 40 L                 | 1,120 L                       |
| 5   | INDIVIDUA L | TËRSHËRË       | 9.70                  | 2500 kg                        | 200 kg               | 200 kg                 | 1940/kg                        | 1940/kg                     | 40 L                 | 388 L                         |
|     | GJITHSEJ    |                | 3,569,98/ ha          |                                |                      |                        |                                |                             |                      | 144,217.6/L                   |

12.11.2024

VITI

Drejtori i Bujqësisë  
Naim Pira